

Nr.regj 62579/12

DPE/DMP

03-1412/13

02

15-05-2013

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni i Kundërvajtjes, me gjyqtarin Shpend Krasniqi dhe Sek. Juridike Iqrame Aliu, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Jovica Steviq nga Graçanica, për kundërvajtje nga neni 7 i Ligjit Nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtar, e në bazë të nenit 73,74, si dhe neni 198 par. 1 pika 8 të Ligjit mbi kundërvajtje, me dt. 19.04.2013 merr këtë:

AKTVENDIM

PEZULLOHET procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit Jovica Milorad Steviq i lindur me 13.02.1970 në Prishtinë, tani jeton në Graçanicë për kundërvajtje nga neni 7 i Ligjit Nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollimin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtar .
Pezullimi bëhet konform neni 198 par. 1 pika 8 të LMK-së, pasi që nuk ka prova që i pandehuri ka kryer kundërvajtje.

Shpenzime të procedurës nuk ka patur.

Nga një ekzemplar të këtij aktvendimi i dorëzohet të pandehurës dhe ushtruesit të kërkesës.

Arsyetim


Agjencia Kundër Korrupsionit, parashtrori kërkesën nr. 01-4280/12 të datës 26.11.2012 për zhvillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit e për kundërvajtjen e cekur më lartë.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, Gjykata inicioj procedurën kundërvajtëse me marrjen e të pandehurit në pyetje i cili në seancën verbale gjyqësore të mbajtur me datën 21.03.2013, deklaroi se nga data 18 maj 2012 është emruar Këshilltar i KK të Graçanicës, dhe nuk e ka ditur së si këshilltar komunal është i detyruar ta deklaronte prejardhjen e pasurisë. Nga Agjencia Kundër Korrupsionit nuk ka marr kurrfarë kërkesë lidhur me këtë çështje. Shefin e Personelit të komunës së Graçanicës e ka pyetur kur e ka nënshkruar kontratën së a duhet diçka tjetër dhe ajo i ka thenë së nuk duhet asgjë tjetër.

Gjykata me qëllim të sqarimit, plotësimit dhe verifikimit të kësaj çështje juridike, ka ftuar dhe marrur në pyetje dy dëshmitarë dhe atë;

Agron Behramin - Shef i Divizionit në Agjencinë Kundër Korrupsionit, nga deklarata e të cilit rezultoi se me datën 25.09.2012, Zyrtarja kontaktuese Aleksandra Gjekiq nga Komuna e Graçanicës ka njoftuar Agjencionin Kundër Korrupsionit së ka ndryshime në listen e të emruarëve se Jovica Steviq është emruar Këshilltar i KK të Graçanicës, Agjencia ka verifikuar listen e zyrtarëve kush e ka deklaruar prejardhjen e pasurisë dhe është konstatuar së Zyrtari Jovica Steviq nuk e ka deklaruar pasurinë dhe pastaj është inicuar procedura kundërvajtëse ndaj tij. Pastaj shton së; Agjencioni Kundër Korrupsionit në secilin vit në muajin shkurt mban trajnime me zyrtarët kontaktues duke i njoftuar me proceset e deklarimit të pasurisë në përgjithësi si dhe obligimet që kanë këta zyrtarë për njoftimin e Agjencionit dhe njoftimin e Zyrtarëve public lidhur me deklarimin e pasurisë.

Dëshmitarja tjetër Aleksandra Gjekiq - Udhëheqëse e personelit në Komunën e Graçanicës, deklaroi së Këshilltari Steviq e ka zëvendësuar një këshilltar tjetër. Nuk e ka njoftuar këtë zyrtar për obligimin që ka patur për deklarimin e pasurisë, sepse as ajo vetë nuk e ka ditur së ky këshilltar ka qenë i obliguar ta deklaronte pasurinë. Agjencia Kundër Korrupsionit një herë në vit organizon trajnime me zyrtarë kontaktues. Në ato trajnime nuk ka kërkuar sqarime sepse nuk ka patur përkthyes. Në këtë vit (2013) ka kërkuar të këtë përkthyes dhe për atë rast i ka të qarta lidhur me punët që i kryen për njoftimin e zyrtarëve të lartë për deklarimin e pasurisë. Në muajin shtator 2012 Agjencia ka kërkuar prej saj që ti jap shenimet së në Komunën e Graçanicës a ka ndryshime në emrimet të zyrtarëve të lartë, atyre u ka thenë së në vend të Këshilltarit Periq ka artur Këshilltari Steviq, por ata nuk i kanë thënë asgjë tjetër lidhur me atë së ai është i



02.1312/14/02
Kryer

obliguar ta deklaroj pasurinë, ndërsa zyrtarja thotë së ajo ka menduar së ky këshillarë është i obliguar në procedure të rregulltë ta deklaroj pasurinë për vitin 2013 e jo menjëherë pas emrimit të tij si zyrtar i lartë dhe lëshimi i afatit për deklarimin e pasurisë nga ky zyrtar është bërë sepse nuk ka qenë i informuar së është i detyruar që menjëherë pas emrimit të tij në detyrë ta deklaron pasurinë.

Andaj në rastin konkret, është i pakontestueshëm fakti së i pandehuri, në kohë nuk ka qenë i informuar (as që i janë dërguar formularët për plotësimin e tyre) as nga zyrtarja kontaktuese e Komunës së Graçanicës e as nga Agjencia Kundër Korrupsionit. Ditën e nënshkrimit të kontratës së punës ka pyetur zyrtarën e cekur me lartë, së çfarë obligimesh tjera ka për t'i kryer dhe ajo i ka thënë së nuk ka obligime tjera.

Në rastin konkret nuk ka prova se i pandehuri ka kryer vepër kundërvajtëse siç pretendon parashtruesi i kërkesës.

Andaj në mungesë të provave së i pandehuri ka kryer kundërvajtje si në kërkesën e parashtruar, e në vështrim të neni 198 par.1 pika 8 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, ndaj të pandehurit u **PEZULLUA** procedura dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës mund të ushtrojnë ankesë e cila i adresohet Gjykatës së Apelit - Divizionit për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh pas pranimit të të njëjtit, përmes kësaj Gjykate e pa taksa.

VENDOSI: GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni i Kundërvajtjes, me datë 19.04.2013.

